**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**
**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**

Tiranë, më 04/10/2017

**Lënda**: Kërkesë për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të subjektit **Gjetan Kol Gjetani.**

**Drejtuar**: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, ku specifikohet se: "*Verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, kryhet sa herë kjo kërkohet nga 1/10 e deputetëve, për një deputet të Kuvendit të Shqipërisë apo një anëtar të Këshillit të Ministrave, përfshirë Kryeministrin, për një të zgjedhur në organet e bashkisë apo të qarkut, si dhe për anëtarin apo drejtuesin e një organi kushtetues apo të krijuar me ligj dhe që zgjidhet me votim nga Kuvendi i Shqipërisë*", kërkojmë nga ana ana juaj verifikimin e plotë të të dhënave të deklaruara në Formularin e Vetëdeklarimit nga subjekti **Gjetan Kol Gjetani, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë**.

Nga të dhëna të bëra me dije në rrugë informale, ekziston dyshimi i arsyeshëm se **subjekti Gjetan Gjetani**, ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, për shkak të rekordeve kriminale në shtetin Italian. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj që në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 8 i këtij ligji, të bëni verifikimin e plotë të të dhënave. Kjo kërkesë e jona, bëhet në kushtet kur pavarësisht fakteve të njohura botërisht, institucioni juaj nuk ka kërkuar verifikimin e plotë të të dhënave kryesisht, në përputhje me pikën 4 të nenit 8 të ligjit nr. 138/2015.

Në pritje të dhënies rrugë kësaj kërkese në përputhje me ligjin,
**DEPUTETËT:**

1. Ervin Salianji
2. Endri Hasa
3. Nadire Meçonepaj
4. Hekuran Hoxholli
5. Klevis Balliu
6. Rudina Hajdari
7. ISUF ÇELAJ
8. GRIDA (DUMA) SHQINA
9. Bardh Spahia
10. Luan Baçi
11. Fatbardha Kadiu
12. Romeo Kurakulli
13. Ardian Krasniqi
14. Florjon Mima
15. ENKELEJDA ALIBEAJ
16. Aldo Bumçi
17. Oduard Koliçaj
18. Flamur Noka
19. EDI PALOKA
20. Jorida Tabaku
21. Dhurata Çupi
22. LUCIANO BOÇI
23. Lindita Metaliaj
24. Albana Vokshi
25. Izmira Ulqinaku

26. Andon Frrokaj

27. Genc Pollo

28. Myslim Murrizi

29. Lulzim Basha

30. Xhemal Gjunkshi

31. Valentina Duka

32. ORJOLA PAMPURI

33. Tritan Shehu

34. Gent Strazimiri

35. Oerd Bylykbashi

36. Lorenc Luga

37. Edmond Spaho

38. 

39. 

40. 

41. 

42. 

43. 